



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Tiranë, më datë 21.08.2020

Nr. 836 Prot.

VENDIM

Nr. 292, datë 21.08.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.08.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërtimi i kullës metalike për antenë të telefonisë 1306 Garda HQ, me investitor “VODAFONE ALBANIA” sh.a. dhe aplikues “INTRACOM TELECOM ALBANIA” sh.a.;
 2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Arta DOLLANI

KRYETAR

Eva MARGARITI

